



UNIVERSITETI I PRISHTINËS FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 209 * Email: edukimi@uni-pr.edu * edukimi.uni-pr.edu

Abstrakt i zgjeruar

Titulli i Punimit:

MËSIMDHËNIA EFEKTIVE NË KONTEKST TË NGARKESËS SË PUNËS DHE SFIDAVE TË KURRIKULËS: ROLI NDËRMJETËSUES I BASHKËPUNIMIT KOLEGIAL

Autori:

Erëza Zasella

Mentori:

Prof. Dr. Naser Zabeli

Programi:

Mastër në Shkencat e Edukimit, Pedagogji

Viti akademik:

19.05.2026

Hyrja

Mësimdhënia efektive konsiderohet një ndër komponentët më të rëndësishëm të cilësisë në arsim, mirëpo ajo ndikohet nga faktorë të ndryshëm profesionalë dhe organizativë, përfshirë ngarkesën e lartë të punës dhe sfidat e kurrikulës. Ngarkesa e punës përfshin përgjegjësi që shkojnë përtej procesit mësimor, si përgatitja e materialeve, detyrat administrative, numri i madh i nxënësve dhe angazhimet individuale me ta, të cilat mund të ndikojnë në kohën dhe energjinë e mësimdhënësve për realizimin e mësimdhënies efektive. Po ashtu, sfidat kurrikulare dhe mungesa e burimeve adekuate krijojnë vështirësi në planifikimin dhe zbatimin e procesit mësimor. Në këtë kontekst, literatura sugjeron se bashkëpunimi kolegjial luan rol mbështetës dhe zbeh ndikimet negative të ngarkesës së punës dhe sfidave kurrikulare në efektivitetin e mësimdhënies. Qëllimi i studimit ishte të analizojë marrëdhënien ndërmjet ngarkesës së punës, sfidave kurrikulare dhe efektivitetit të mësimdhënies të mësimdhënësit, duke shqyrtuar rolin ndërmjetësues të bashkëpunimit kolegjial në këtë lidhje.

Metodologjia

Studimi kishte qasje kuantitative dhe dizajn korrelacional. Për realizimin e hulumtimit u përzgjedhën 3 shkolla të mesme të larta dhe 11 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta në qytetin e Mitrovicës, prej të cilave 4 ishin shkolla që zhvillojnë veprimtarinë në fshatrat e Mitrovicës. Përzgjedhja e mostrës u realizua përmes numrave rastësor të gjeneruar në mënyrë

automatike online. Në hulumtim morën pjesë gjithsej 303 mësime, ku 8 prej tyre nuk raportuan gjininë dhe nivelin e shkollimit. Nga të dhënat e raportuara, 199 apo 65.7% e pjesëmarrësve ishin gra dhe 96 apo 31.7% burra. Të dhënat u mbledhën duke përdorur instrumentin Trends in International Mathematics and Science Study (TIMSS) për matjen e bashkëpunimit kolegjial, efektivitetit në mësime, ngarkesës së punës dhe sfidave kurrikulare. Analizat statistikore u realizuan në programin SPSS. Për analizimin e marrëdhënieve ndërmjet variablave u përdor korelacioni Pearson, ndërsa ndikimi i variablave të pavarura në efektivitetin e mësimeve u vlerësua përmes regresionit linear. Për testimin e rolit ndërmjetësues të bashkëpunimit kolegjial u përdor PROCESS Macro i Andrew F. Hayes në SPSS (Modeli 4). Rezultatet e analizës së besueshmërisë treguan se Cronbach's Alpha ishte në nivel të kënaqshëm dhe të lartë për të gjitha variablat e studiuar.

Rezultatet kryesore

Rezultatet e hulumtimit treguan se hipoteza H1 u konfirmua, pasi mësimeve raportuan nivel mesatar të efektivitetit në mësime, duke reflektuar angazhim në planifikimin e mësimit, përshtatjen e metodave sipas nevojave të nxënësve dhe krijimin e një klime mbështetëse në klasë. Hipoteza H2 u konfirmua pjesërisht, pasi sfidat kurrikulare rezultuan të kenë ndikim negativ në efektivitetin e mësimeve, ndërsa ngarkesa e punës ndikim pozitiv, ndonëse në hipotezë ishte paraparë që të dyja variablat të kishin efekt negativ. Hipoteza H3 u konfirmua, pasi bashkëpunimi kolegjial rezultoi në nivel mesatar dhe tregoi lidhje pozitive me efektivitetin në mësime. Analiza e ndërmjetësimit tregoi se bashkëpunimi kolegjial luan rol ndërmjetësues ndërmjet sfidave kurrikulare, ngarkesës së punës dhe efektivitetit të mësimeve, duke konfirmuar hipotezën H4.

Diskutimi

Rezultatet sugjerojnë se mjediset shkollore që inkurajojnë punën ekipore, mentorimin dhe shkëmbimin e praktikave profesionale krijojnë kushte më të favorshme për zhvillimin profesional të mësimeve dhe përmirësimin e cilësisë së mësimeve. Lidhja pozitive ndërmjet bashkëpunimit kolegjial dhe efektivitetit në mësime thekson rëndësinë e praktikave bashkëpunuese në mbështetjen e mësimeve përballë sfidave profesionale. Po ashtu, ndikimi negativ i sfidave kurrikulare tregon se vështirësitë në zbatimin e kurrikulës dhe mungesa e mbështetjes institucionale mund të pengojnë realizimin e mësimeve efektive. Ndërkohë, ndikimi pozitiv i ngarkesës së punës mund të sugjerojë se ajo nuk perceptohet vetëm si barrë, por edhe si tregues i angazhimit dhe përkushtimit profesional të mësimeve.

Përfundimet dhe rekomandimet

Në përfundim, bashkëpunimi kolegial u identifikua si faktor kyç për ruajtjen dhe përmirësimin e efektivitetit në mësimdhënie, ndërsa sfidat kurrikulare vazhduan të ndikojnë negativisht në procesin mësimor, veçanërisht në mungesë të mbështetjes institucionale dhe kushteve adekuate të punës. Gjetjet theksojnë rëndësinë e krijimit të kulturës bashkëpunuese në shkolla, investimit në mbështetje profesionale dhe zhvillim të vazhdueshëm të mësimdhënësve.

Studimi rekomandon forcimin e praktikave bashkëpunuese mes mësimdhënësve përmes ndarjes së përvojave, bashkëplanifikimit dhe mentorimit. Gjithashtu, rekomandohet realizimi i hulumtimeve të tjera mbi faktorë shtesë që ndikojnë në efektivitetin e mësimdhënies, ngarkesën në punë dhe sfidat profesionale, si dhe përdorimi i instrumenteve dhe qasjeve të ndryshme matëse për të kuptuar më mirë këto variabla dhe ndikimin e tyre në praktikën arsimore.

Fjalë kyçe: *mësimdhënia efektive, ngarkesa e punës, sfidat kurrikulare, bashkëpunimi kolegial, cilësia në arsim*

Extended Abstract

Title of the Thesis:

EFFECTIVE TEACHING IN THE CONTEXT OF WORKLOAD AND CURRICULUM CHALLENGES: THE MEDIATING ROLE OF COLLEGIAL COLLABORATION

Author:

Erëza Zasella

Supervisor:

Prof. Dr. Naser Zabeli

Program:

Master of Educational Sciences, Pedagogy

Academic Year:

19.05.2026

Introduction

Effective teaching is considered one of the most important components of educational quality; however, it is influenced by various professional and organizational factors, including high workload and curriculum challenges. Workload includes responsibilities that extend beyond the teaching process, such as preparation of teaching materials, administrative duties, large numbers of students, and individual engagement with them, all of which may affect teachers' time and energy for implementing effective teaching practices. In addition, curriculum challenges and the lack of adequate resources create difficulties in planning and implementing the teaching process. In this context, the literature suggests that collegial collaboration plays a supportive role and mitigates the negative effects of workload and curriculum challenges on teaching effectiveness. The aim of the study was to analyze the relationship between workload, curriculum challenges, and teaching effectiveness among teachers, while examining the mediating role of collegial collaboration in this relationship.

Methodology

The study employed a quantitative approach and a correlational research design. For the purpose of this research, 3 upper secondary schools and 11 primary and lower secondary schools in the city of Mitrovica were selected, of which 4 schools operated in the rural areas

of Mitrovica. The sample was selected through randomly generated numbers using an online automated procedure. A total of 303 teachers participated in the study, while 8 participants did not report their gender and level of education. Of the reported data, 199 participants or 65.7% were women and 96 participants or 31.7% were men. Data were collected using the Trends in International Mathematics and Science Study (TIMSS) instrument to measure collegial collaboration, teaching effectiveness, workload, and curriculum challenges. Statistical analyses were conducted using SPSS. Pearson correlation was used to analyze the relationships between variables, while linear regression analysis was employed to assess the impact of independent variables on teaching effectiveness. To test the mediating role of collegial collaboration, the PROCESS Macro by Andrew F. Hayes in SPSS (Model 4) was used. Reliability analysis indicated that Cronbach's Alpha coefficients were satisfactory and high for all studied variables.

Main Findings

The findings showed that hypothesis H1 was confirmed, as teachers reported a moderate level of teaching effectiveness, reflecting engagement in lesson planning, adaptation of teaching methods according to students' needs, and the creation of a supportive classroom climate. Hypothesis H2 was partially confirmed, since curriculum challenges showed a negative effect on teaching effectiveness, whereas workload demonstrated a positive effect, although the hypothesis initially predicted negative effects for both variables. Hypothesis H3 was confirmed, as collegial collaboration was found at a moderate level and showed a positive relationship with teaching effectiveness. Mediation analysis revealed that collegial collaboration plays a mediating role between curriculum challenges, workload, and teaching effectiveness, thereby confirming hypothesis H4.

Discussion

The findings suggest that school environments that encourage teamwork, mentoring, and the exchange of professional practices create more favorable conditions for teachers' professional development and the improvement of teaching quality. The positive relationship between collegial collaboration and teaching effectiveness highlights the importance of collaborative practices in supporting teachers in dealing with professional challenges. Furthermore, the negative impact of curriculum challenges indicates that difficulties related to curriculum implementation and insufficient institutional support may hinder effective teaching practices. Meanwhile, the positive effect of workload may suggest that workload is not perceived solely as a burden, but also as an indicator of teachers' engagement and professional commitment.

Conclusions and Recommendations

In conclusion, collegial collaboration was identified as a key factor in maintaining and improving teaching effectiveness, while curriculum challenges continued to negatively affect the teaching process, particularly in the absence of institutional support and adequate working conditions. The findings emphasize the importance of fostering a collaborative culture within schools, investing in professional support, and promoting teachers' continuous professional development.

The study recommends strengthening collaborative practices among teachers through experience sharing, co-planning, and mentoring. Furthermore, future research should investigate additional factors influencing teaching effectiveness, workload, and professional challenges, as well as apply different measurement approaches to better understand these variables and their impact on educational practice.

Keywords: *effective teaching, workload, curricular challenges, peer collaboration, quality in education*